



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.3. pikën b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Arcum Studio" të datës 23.05.2023 për shkak të dosjes së tenderit (tutje "DT") lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sistemet intelegjente të menaxhimit të ndërtesave dhe zyrave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-23-2423-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Arcum Studio" e datës 23.05.2023 për shkak të dosjes së tenderit (tutje "DT") lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sistemet intelegjente të menaxhimit të ndërtesave dhe zyrave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-23-2423-2-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues që të publikoj B54 formularin për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara përmes të cilit do të riformulohet kërkesa nr. 2 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional "Menagjeri i projektit - (BMS) inxhnjer apo master i qertifikuar per sisitemin e ndertesave"(9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale) në përputhje me nenin 69 lidhur me nenet 1, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.
- III. **DETYROHET** autoriteti kontraktues që të bëj zgjatjen e afatit për dorëzimin e tenderëve në përputhje me nenin 53 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.
- IV. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Arcum Studio" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Arcum Studio" (tutje "parashtruesi) me datë 23.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim për shkak të dosjes së tenderit (tutje "DT") lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sistemet intelektuale të menaxhimit të ndërtesave dhe zyrave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-23-2423-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtruesit është cituar si në vijim: *"Duke e pas parasysh sistemin e kualifikimit shkollor edukativ në Kosovë nuk ka një drejtim në asnjërin nga fakultetet për Inxhinier për BMS e as ndonjë trup qertifikuese për sistemin e ndërtesave. Andaj duke u bazuar në këtë kërkojmë që pika 9.1&9.2 të ndryshohet dhe të caktohet Inxhinieri adekuatë për punët e kërkuara në bazë të specifikave teknike dhe paramasës si dhe të definohet sakt kualifikimi akademik për inxhinierin e kërkuar".*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 60 dhe 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP").

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 31.05.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- B05 Njoftimi për kontratë si dhe dosja e tenderit, dt. 21.03.2023.
- B54 Formulari për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dt. 27.04.2023.
- B54 Formulari për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dt. 11.05.2023.
- B54 Formulari për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dt. 12.05.2023.
- B54 Formulari për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dt. 17.05.2023.
- B54 Formulari për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dt. 29.05.2023.
- Kërkesat për sqarime në DT dhe përgjigjet nga AK.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit fillimisht duhet cekur se sipas dosjes së tenderit ("DT") lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional është përcaktuar kërkesa si në vijim "Menagjeri i projektit - (BMS) inxhnjer apo master i qertifikuar per sisitemin e ndërtesave"(9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale). Pretendimi i parashtruesit është që në Republikën e Kosovës nuk ekziston ndonjë program akademik i akredituar ekskluzivisht për sistemin e menaxhimit të ndërtesave. Nëse analizohet me kujdes formulimi në dosjen e tenderit, ky kriter si i tillë është alternativ pasi që do duhej të konsiderohej i përmbushur nëse operatori ekonomik ofron

dëshmitë se ka të punësuar/kontraktuar së paku një (1) inxhiner për sistemin e ndërtesave apo së paku një (1) master për sistemin e menaxhimit të ndërtesave. Mbi bazën e këtij interpretimi gjuhësor të kriterit përkatës në DT, zyrtari i përgjegjës i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese sqarime nëse formulimi i kriterit si i tillë është në përputhje me nenin 1, 6, 7 dhe 69 të LPP. Sidoqoftë njësia kërkuese e këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka arritur që të sigurojnë shpjegimet e nevojshme sipas të cilave do të sigurohej që ky kriter nuk i kufizon parimet themelore të LPP të cilat janë Ekonomiciteti/Efikasiteti dhe Barazia në trajtim/Jodiskriminimi i tenderuesve. Njëkohësisht zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk ka arritur që të evidentoj që në Republikën e Kosovës ekziston ndonjë program akademik i akredituar ku mund të diplomohet në sistemin e menaxhimit të ndërtesave (BMS). Fakti që zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk ka arritur të evidentoj ndonjë program të tillë, nuk nënkupton që ato nuk ekzistojnë por definivisht janë të kufizuara në numër (ose edhe nuk ekzistojnë fare). Ky fakt si i tillë mund të ndikoj në kufizimin e konkurrencës së tenderuesve në këtë aktivitet të prokurimit që është shkelje e drejtpërdrejtë e parimeve të përcaktuara me LPP. Në cilindo rast kërkesat mbi kualifikimin shkollor të stafit të operatorëve ekonomik duhet të jenë në përputhje jo vetëm me qëllimin e aktivitetit të prokurimit por edhe standardeve të konsoliduara me LPP dhe legjislacionin tjetër në fuqi në RKS. Kësisoj nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është i bazuar.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është i bazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është miratuar si e bazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.3. nënparagrafin b) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 31.05.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.